

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE: 28.09.2020
DATUM: 28.09.2020
DATE: 28.09.2020

Nr. Prot. Br. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
1705	5

Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
03 47



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansija
Ministry of Finance
Thesari - Trezor - Treasury

Nr. Prot. Br. Prot. No.: 129
Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages: 1
Data Datum: 28.09.2020

Mësisë Org. Jedin. Org. Unit: Thesari
Dësië PRISHTINE/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansija - Ministry of Finance
Thesari i Kosovës - Trezor Kosova - Treasury of Kosovo

DATË/A:	28 Shtator 2020
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Z. Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm, Zyra Kombëtare e Auditimit
PERMES/THROUGH:	Znj. Hykmete Bajrami, Ministre e Ministrisë së Financave
NGA/OD/FROM:	Z. Ahmet Ismaili, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit, MF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i planit të veprimit për rekomandimet RVA-2019



I nderuar Auditor i Përgjithshëm,

Përmes kësaj shkrese ju dërgojmë bashkëngjitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve në nivel të Qeverisë së Republikës së Kosovës të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2019 (RVA 2019), në vijim dhe si përgjigje ndaj shkresës suaj nr. 1567, të datës 28.08.2020.

Plani i veprimit për zbatimin e 25 rekomandimeve nga RVA 2019, të cilin e gjeni bashkëngjitur kësaj shkrese është konsoliduar nga Thesari dhe Ministria e Financave në bashkëpunim, në bazë të inputit nga ministritë e linjës, dhe përmban aktivitete konkrete drejt zbatimit të tyre, duke synuar rritjen e nivelit të përgjegjësisë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të zbatimit të rekomandimeve të dala nga RVA 2019. Për dijeni, në këtë plan nuk përfshirën rekomandime për Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendet Komunale, megjithatë rekomandimet përkatëse të RVA 2019 u janë dërguar zyrtarisht Sekretarit të Kuvendit dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal, përkatësisht.

Për dijeni, plani është shqyrtuar dhe aprovuar në mbledhjen Nr. 33 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në pikën 5 të rendit të ditës, ndërsa parashihet që dy herë në vit do të monitorohet zbatimi i tij, përfshirë edhe rishikimin sipas nevojës. Një kopje sipas këtij plani i dërgohet edhe Komisionit përkatës në Kuvendin e Kosovës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj,

Me respekt,



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansija - Ministry of Finance
 Thesari i Kosovës – Trezor Kosova - Treasury of Kosova

Plani për zbatimin e rekomandimeve sipas Raportit vjetor të auditimit për vitin 2019

Nr	Nr. i faqes ne RVA	Rekomandimet	Institucioni përgjegjës	Aktivitetet që do të ndërmerren nga menaxhmenti/ Komentet	Koha e propozuar për Zbatim
Ministria e Financave					
1	20	1. Ministria e Financave duhet të vazhdojë me masat e filluara me përmirësimin e kontrolleve buxhetore, në mënyrë që shumata e keqklasifikuara me buxhet të reduktohen sa më shumë; 2. Me rastin e planifikimit të të hyrave buxhetore, të siguroj se ekzistojnë analiza të mjaftueshme dhe të qarta për dokumentimin e burimeve përkatëse të të hyrave. Departamenti i Makroekonomisë, Departamenti i Buxhetit dhe Thesari duhet të punojnë ngushtë për eliminimin e këtyre gabimeve, para se Planit buxhetor t'i dorëzohet Qeverisë. Në veçanti, duhet të bashkëpunojnë lidhur me të dhënat e paraqitura në Tabelën 1 dhe të analizohen ndikimet e mëvonshme në Pasqyrat Financiare	MF/Departamenti i Buxhetit	1. Ministria e Financave përmes Departamentit të Buxhetit do të kujdeset që të respektohen kriteret e projekteve kapitale ne perputhje me UA ne fuqi, dhe klasifikimi i tyre te behet ne perputhje me kategorine e shpenzimit. 2. Strukturat perkatese ne MF (Thesari, Makro, Buxheti) gjate planifikimit te tabelës 1 te ligjit te buxhetit per vitin 2021, do te kujdesen qe burimet e financimit te definohen dhe paraqiten ne perputhje me kerkesat e standardeve dhe rekomandimit	TM4/2020
2	20	Departamenti i Makroekonomisë, në Tabelën 1 të shpalos planin e të hyrave jo tatimore të nivelit qendror, sipas OB-ve, dhe i njëjti të shërbejë si plan i të hyrave për secilin OB në pasqyrat financiare;	MF/Departamenti për Politikë Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar	MF gjate procesit buxhetor te vitit 2021 dhe vazhdim, do te pergatis nje matrice dhe zbertheje te hyrat jo tatimore te planifikuara te HQ sipas OB, per qellime orientuese dhe planifikuese.	TM4/2020
3	20	1. Thesari të kërkojë nga komunat që ta dërgojnë planin e rrjedhës së parasë edhe për të hyrat vetjake të bartura, ashtu që të ketë një financim të balancuar të buxhetit, gjithnjë duke respektuar të drejtën që komunat e kanë për të destinuar këto mjete në kohën dhe projektet e caktuara; dhe 2. Me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të Buxhetit, për të gjitha lëvizjet dhe ndryshimet në librat kontabël të SIMFK duhet të mbeten gjurmë, ndërsa vetëm Thesari si ekzekutues i buxhetit (përkatesisht zbatues i ligjit) të realizojë ndryshimet në librat kontabël, duke përfshirë ekzekutimin e të gjitha vendimeve për ndryshime të ndryshme buxhetore në përputhje me vendimet e marra në pajtim me legjislacionin.	MF/Departamenti i Buxhetit dhe Thesari i Kosovës	1. Thesari me rastin e implementimit te reformes se menaxhimit te rrjedhes se parasë dhe alokimeve, gjegjesisht Modulin ne kuader te SIMFK-se, "Forcimi ne planifikimin dhe ekzekutimin e Buxhetit" nga viti 2021, do te kërkoj nga OB-të, qe te pergadisin Planin e rrjedhës së parasë për të gjitha fondet përfshirë edhe fondin 22/te hyrat e bartura. 2. Me rastin e transference/levizjeve buxhetore nga ligji i buxhetit ne fuqi, pas aprovimit nga autoriteti perkatës (Kuvendi, Qeveria, Ministri) ndryshimet ne regjistrat kontabel do te realizohen nga Thesari (ekzekutim buxheti), pasi te pranohet vendimi perkatës qe pergatitet dhe rekomandohet nga departamenti i buxhetit ne MF. Me kete rast, ne nje kolone te vecante do te paraqiten keto ndryshime te aprovuara sipas LMPPP, qe nuk do te afektojne buxhetin fillestar me ligjin e buxhetit, duke mos e mbishkruar ate.	1. TM2/2021 2. TM1-TM4/2021
4	41	1. MF duhet që përfundimisht me rastin e përgatitjes së Buxhetit fillestar të sqarojë të gjithë zërat buxhetor në mënyrë që bartja e të dhënave nga Tabela 1 në Pasqyra Financiare të jetë e qartë, konsistente dhe pa gabime.	MF/Departamenti për Politikë Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar	Thesari ne bashkepunim me departamentin përgjegjës per makroekonomine, gjate hartimit te pasqyrave financiare do te sigurohet se zerat buxhetore barten ne perputhje me tabelen 1 te ligjit te buxhetit per vitin 2020, sipas kerkesave te LMPPP si dhe SNKSP	TM1/2021
5	41	2. Ministri i Financave dhe Departamenti i Buxhetit duhet të sigurojnë se me rastin e aplikimit të organizatave buxhetore për fonde shtesë për nevoja urgjente apo të paparashikuara, të shpjegojnë në hollësi rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojën për këto fonde, të shpjegohen arsye për këto rrethana nuk kanë mundur të parashikohen dhe të identifikohen me rastin e përgatitjes së rregullit të buxhetit, dhe pas shqyrtimit nga Ministria e Financave, të dërgohen në Qeveri për aprovimin dhe ndarjen e këtyre fondeve nga rezerva.	MF/Departamenti i Buxhetit & Zyra e SP	Në rastin e paraqitjes së kërkesave për fonde shtesë për nevojat urgjente dhe të paparashikuara, Ministria e Financave do të kujdeset që të kërkojë shpjegimin e arsyeshëm të rrethanave dhe me këtë arsytim dhe në bazë të këtyre do të epet opinionin i Departamentit të Buxhetit. Po ashtu, një dispozitë ligjore do të përfshihet në Ligjin vjetor të Buxhetit për vitin 2021, duke përcaktuar kriteret të qarta dhe të detajuara për zbatimin e nenit 29 të LMPPP-së.	TM1/2021

6	53	<p>1. Ministria e Financave, duhet të vazhdoj me veprimet e ndërmarra në adresimin e projekteve që financohen nga huamarrja dhe t'i paraqes dy herë në vit Qeverisë për informim dhe shqyrtim raport të konsoliduar të progresit të projekteve, duke i identifikuar sfidat përkatëse dhe duke propozuar masat për tejkalimin e tyre.</p> <p>2. Të miratohet ligjin e rishikuar të borxhit publik, i cili ka adresuar në masë të konsiderueshme aspektet e trajtuara në këtë raport, që ka të bëjë me hyrjen në borxh dhe një qasje të bazuar në vlerësimin e nevojave nga MF, dhe jo nga organizatat zbatuese me kreditorët.</p>	MF/Thesari i Kosovës	<p>1. Do të vazhdohet të përgatitet raporti dhe të dërgohet në Qeveri sipas rekomandimit. Raporti herën e parë do të dërgohet 60 ditë pas mbylljes së vitit fiskal dhe raportimi i dytë do të bëhet gjatë muaj nga raportimi i parë.</p> <p>2. Ligji për borxhin publik i rishikuar është në konsultime shtesë i cili do të dërgohet për aprovim në Qeveri.</p>	<p>1. TM1/ 2021 TM4/2021</p> <p>2. TM4/ 2020</p>
7	53	3. Para aprovimit të buxhetit (projekteve kapitale dhe jo vetëm), të monitoroj zbatimin e kritereve përzgjedhëse si dhe prioritetet e projekteve. Miratimi i projekteve duhet të bëhet vetëm nëse për to janë kryer të gjitha përgatitjet dhe ekziston siguri e mjaftueshme dhe e dokumentuar se realizimi i projekteve do të bëhet në kohën e duhur.	MF/Departamenti i Buxhetit	Udhëzimi administrativ për kritere përzgjedhëse të projekteve kapitale ka hyre në fuqi me 1 Janar 2020 dhe OB kanë obligim ligjor zbatimin e këtij UA, nëse OB nuk reflektojnë, MF nuk do të përfshijë në propozim buxhetin që dërgohet në Qeveri nëse OB-të nuk respektojnë këto udhëzime administrative, duke filluar nga projektbuxheti për vitin 2021, që përgatitet gjatë vitit 2020.	TM4 2020
8	57	<p>1. Thesari përmes trajnimeve të fund vitit lidhur me hartimin e Pasqyrave financiare, të fuqizoj kërkesën që të gjitha organizatat buxhetore t'i themelojnë me kohë komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, dhe rezultatet e inventarizimit t'i reflektojnë në pasqyrat financiare të fundviti.</p> <p>2. Me rastin e pranimit të PFV-ve nga organizatat buxhetore, të vendos kontrolle formale në veçanti lidhur me raportimin e stoqeve me gjendjen zero, dhe në rastet e tilla të kërkoj sqarime, ngase në raportet e tri viteve të fundit ka diferencë të theksuara dhe raportim të mangët.</p>	MF/Thesari i Kosovës & OB	<p>1. Thesari do të organizoj punëtori [duke përfshirë opsion për takim virtual] në fundvit me organizatat buxhetore do të ri-ngris çeshtjen që lidhen me komisionet e inventarizimit si dhe vlerësimit të pasurive, në respektimin e rregullores financiare për menaxhimin e pasurive jofinanciare.</p> <p>2. Gjatë takimit që do të organizohet në fundvit me organizatat do të diskutohet dhe do të kërkojë që të respektohet rregullorja për raportim vjetor financiar të organizatave buxhetore, pjesë e së cilës rregullore janë edhe stoqet.</p>	<p>1. TM4/2020</p> <p>2. Q4/2020</p>
9	62	Ministria e Financave në koordinim me organizatat që kanë detyrime të paguara, me rastin e ndarjeve buxhetore duhet të kenë prioritet të parë ndarjen e fondeve për pagesën e faturave apo detyrimeve nga vitet e mëhershme në mënyrë që të mënjanojnë shpenzimet shtesë të kamatave dhe shpenzimet tjera administrative.	MF/Dep. Buxheti & Thesari	Thesari do t'i dërgoj departamentit të buxhetit raportin e përmbledhur mujor të pranuar nga OB lidhur me detyrimet e paguara të raportuara, ndërsa departamenti i buxhetit do të kujdeset që të njëjtat t'i prioritetizojë gjatë përcaktimit të ndarjeve buxhetore, përkatësisht diskutimit me OB lidhur me domosdoshmerine e buxhetimit të obligimeve të paguara. Departamenti i Buxhetit me rastin e leshimit të qarqores buxhetore dhe gjatë degjimeve buxhetore kërkon nga OB që me prioritet të planifikojë shyerjen e obligimeve kontraktuale.	TM4/2020
10	65	Ministria Financave duhet të udhëzoj dhe kërkoj nga organizatat buxhetore të bëhet një vlerësim i përafërt i detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalojë në RFV të jenë sa më të plota dhe të merren në konsideratë për analiza të mëtejme për adresimin e këtyre detyrimeve. Aty ku gabimisht nuk janë bartur shënimet në PF, të njëjtat të korrigjohen për vitin e ardhshëm dhe që të sigurohen se evitohen gabimet teknike gjatë raportimit.	MF/Thesari Kosovës/ Ministria e Drejtësisë/ Avokatura Shtetore	Thesari do të sigurohet se edhe detyrimet kontingjente do të konsolidohen sakte në PVF në bazë të raporteve individuale të OB; njëkohësisht do të kërkoj nga OB që të koordinohen me Avokaturën Shtetore/Avokatin përgjegjës që në PF Individuale të paraqesin një vlerë të përafërt të secilit detyrim kontingjent me shpalosjet përkatëse	TM1/2021
11	68	<p>1. Me rastin e përgatitjes së Buxhetit vjetor të vitit 2021, Ministria e Financave duhet të kërkoj të gjitha të dhënat nga secila organizatë buxhetore lidhur me paditë e ngritura së bashku me një vlerësim nga zyrtarë ligjorë për mundësinë e daljes së parasë, dhe të njëjtat sipas kategorive përkatëse t'i planifikoj me ndarjet e rregullta buxhetore, në mënyrë që t'i shmangët vështirësitë në sigurimin e fondeve për këto pagesa si dhe reklasifikimit të tyre në kodet ekonomike.</p> <p>2. Specifikisht të kërkojë nga të gjitha OB-të që me rastin e kalkulimit të pagave për stafin e tyre, të përllogarisin edhe detyrimet që dalin nga kontratat kolektive dhe të njëjtin plan t'i dorëzojnë Ministrisë së Financave në mënyrë që këto shpenzime të parashihen me buxhet të rregullt dhe të shmangët proceset gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore shtesë lidhur me këto konteste.</p> <p>3. Si alternativë, të shqyrtojë mundësinë e rritjes së fondit kontingjent në Ministrinë e Financave, dhe nga i njëjti fond, të kompenzohen të gjitha pagesat fillimisht, ndërsa me rishikim buxheti apo me rregullimet e fundviti, të korrigjohet buxheti i organizatave buxhetore për të njëjtat shuma.</p>	MF/Dep. Buxheti (planifikimin/buxhetimin) & Thesari (informata për vendimet & bartjen e shpenzimit)	<p>1. Ministria e Financave do të kërkoj nga OB që të deklarojnë të gjitha obligimet duke përfshirë ato për paditë e ngritura me një vlerësim nga zyrtarë ligjorë/Avokatura;</p> <p>2. Ministria e Financave do të shqyrtojë të gjitha mundësitë që të gjej modalitetet rreth buxhetimit të këtyre obligimeve, pasi të ketë informata me të plote nga OB për shumën e këtyre obligimeve, duke ruajtur rregullën fiskale të pagave sipas LMFPF</p> <p>3.1. Thesari do të informojë departamentin e buxhetit lidhur me vendimet gjyqësore të ekzekutuara gjatë vitit fiskal në kategoritë ekonomike, sipas organizatave buxhetore, që të njëjtat t'i nënshtrohen një vlerësimi për nevojën e ri-klassifikimit në kuadër të kodit adekuat buxhetor, me rregullimet buxhetore në rishikim buxheti apo në fundvit.</p>	<p>1. TM4/2020; TM2/2021</p> <p>2. TM3/2021</p> <p>3.1. TM4/2020 dhe TM1-TM4/2021</p>
12	71	<p>1. Ministri i Financave, të shtoj kontrollet dhe bashkë me krerët e organizatave buxhetore të siguroj se me rastin e planifikimeve, organizatat buxhetore kanë bërë analiza të mirëfillta dhe të qëndrueshme si dhe raportim për të punësuarit faktik të jetë i harmonizuar.</p> <p>2. Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, të sigurojnë se institucionet përkatëse do të respektojnë të gjitha kërkesat ligjore sa i përket të punësuarve me marrëveshje për shërbime të veçanta, duke u përshtatur me kërkesat e Ligjit të ri për zyrtarët publik.</p>	1.MF/Dep. Buxheti 2.MF/Thesari i Kosovës	<p>1. Departamenti i Buxhetit gjatë hartimit të projektbuxhetit 2021 do të bashkëpunojë me OB për të adresuar këto rekomandime si dhe do të kërkojë nga OB qartësi sa me të mëdha lidhur me numrin e të punësuarve faktik dhe pozitiv të lira.</p> <p>2. Thesari do të pasivizojë të gjithë furnitorët individualë në SIMFK, dhe do të përditësojë procedurën e aktivizimit dhe regjistrimit të furnitoreve të rinj, duke vendosur kritere që për të hapur një furnitor të ri individual duhet të arsyetojë dhe konfirmoj se ai nuk bie ndesh me Ligjin për zyrtarët publik dhe nenin 80 të LMFPF.</p>	<p>1. TM 4 2020</p> <p>2. 01 Janar 2021</p>

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministrinë e Linjës

1	41	Qeveria e Kosovës duhet të siguroj se janë krijuar të gjitha kushtet që stafi i punësuar në bazë të Marrëveshjes së Brukselit të vijoj procesin normal të punës. Deri atëherë, në listën e pagave të Thesarit, norma e punës duhet të jetë zero (0). Në të kundërtën, këto pagesa duhet të ndërpriten dhe vazhdimi i këtyre pagesave mund të bëhet nga kategoria e subvencioneve, me një bazë ligjore të mirëfilltë, sepse askush nuk duhet të kompensohet në emër të pagave, përderisa nuk kryen asnjë detyrë pune në interes të punëdhënësit.	Qeveria (MF, Ministrinë e Linjës dhe Thesari)	Ministria e Financave/Thesari do të kërkojë nga të gjitha OB që të sjellin në Thesar listën e stafit të marrëveshjes që i referohet rekomandimit, dhe të njejtat të vendosen me norme 0 në sistemin e pagave. Organizatave buxhetore obligohen që të bashkëpunojnë me Thesarin dhe të sjellin formularet përkatës për ndryshim në listën e pagave në Thesar për zbatim të rekomandimit në fjalë.	TM4/2020
2	53	Qeveria duhet që t'i shqyrtoj raportet periodike për borxhet publike të Ministrisë së Financave, dhe të analizojë ngecjet e identifikuar. Gjithashtu, në baza periodike të analizoj kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve për financim, buxhetim dhe monitorimin e shfrytëzimit të fondeve të huamarrjes, si dhe të shqyrtoj vonesat eventuale në tërheqjen e këtyre fondeve	Qeveria e Kosovës (MF dhe Ministrinë zbatuese të projekteve)	Përmes miratimit të ligjit të rishikuar për borxhin publik, menyra e aplikimit për financim me huamarrje dhe kriteret do të ndryshojnë, ashtu që vetëm projektet e maturuara dhe të gatshme, pas shterrjes së mundësive të financimit nga buxheti i brendshëm, do të kenë mundësi të aprovimit.	TM1/2021
3	57	Pjesërisht përsërisim rekomandimet e vitit të kaluar se Qeveria duhet të luaj një rol proaktiv në adresimin e të gjitha çështjeve lidhur me menaxhimin e pasurive dhe të ndërtoj mekanizma llogaridhënës: 1. Të gjitha organizatat t'i përmbushin detyrimet ligjore, duke i regjistruar dhe raportuar saktë të gjitha pasuritë në posedim; dhe 2. Të merr masa për funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria, si një problem i trashëguar për vite me radhë. Në të kundërtën, të shfuqizoj pjesën e rregullores e cila i obligon OB-të që ta përdorin këtë sistem, dhe të dhënat të mbahen veçmas në programe tjera të OB-ve	MPB	Menaxhmenti i MPB-se do të ndërmerr veprime që të funksionalizohet në teresi sistemi i e-pasurisë, duke shtuar kontrollin sistemetike ndaj zyrtareve përgjegjës të pasurisë.	TM1/2021
4	60	Në koordinim me komunat dhe organizatat tjera që krijojnë të hyra, duhet të analizojnë në hollësi strukturën e këtyre llogarive, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe të trashëguara për vite me radhë. Gjithashtu, nga OB-të duhet të bëhet një vlerësim se cilat nga këto borxhe përmbushin kriteret e borxheve të këqija dhe të njëjtat të shihen nga llogaritë aktive. Qeveria duhet të shqyrtoj edhe masat tjera stimuluese, duke mos përjashtuar edhe masat ligjore për inkasimin e tyre.	Qeveria e Kosovës (ZKM, MF, MAPL)	Ministria e Financave do të kërkojë nga OB të themelojnë komisione të vecanta për të shqyrtuar dhe analizuar strukturën e llogarive të vjetra dhe të dalin me rekomandime përkatëse lidhur me statusin e tyre. Për Komunat, raportet do të dërgohen tek MAPL, dhe të njejtat do të konsolidohen me raportin e përgjithshëm. Ministria e Financave/Thesari dhe ZKM/SKQ do të konsolidojë këto raporte dhe dërgoj në Qeveri për trajtim të mëtejme.	TM1/2021
5	68	Të shqyrtohen të gjitha mundësitë ligjore që për rastet në gjykata, që kryesisht kanë të bëjnë me marrëveshjet kolektive, nga komunat të arrihen marrëveshje jashtë gjyqësore dhe ri-programim i tyre në bazë të mundësive buxhetore dhe të njëjtat t'i planifikojnë në buxhetet e tyre, me qëllim që të shmangin pagesat për tarifa dhe kamata ligjore. Bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor dhe strukturat tjera, gjithashtu do të ishte i nevojshëm.	Qeveria e Kosovës/ MF/MD/MAPL/Komunat	1. MPL do të përgatit rekomandime për komisionin e granteve që komunat të planifikojnë buxhet për të gjitha obligimet e dala nga vendimet gjyqësore në mënyrë që të mos ketë keqklasifikime. 2. Me mbështetje të USAID do të formohet një grup punues në mes të MPL, MF/Thesari & Buxheti, AKK dhe Këshillin Gjyqësor lidhur me arritjen e një marrëveshjeje për ri-programim të këtyre rasteve në gjykata dhe përfshirja e tyre proceset buxhetore komunale gjatë planifikimit.	TM1/2021
6	79	1. Menaxhmenti i OB-ve të cilat janë të obliguara të themelojnë NJAB sipas Rregullores QRK-nr. 01/2019, duhet t'i themelojnë këto njësi, ndërsa OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NJAB, funksionin e auditimit të brendshëm ta përmbushin përmes mënyrave tjera të parapara me këtë rregullore dhe në përputhje me ligjin për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura; dhe 2. Për ta kompletuar sistemin e auditimit të brendshëm, NJAB duhet të plotësohen me staf dhe të themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NJAB-së. Po ashtu, KA duhet të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së, si dhe të dorëzojnë raporte vjetore të punës, siç kërkohet me UA.	Qeveria e Kosovës/MF & NJQH/AB	1. Njësia Qendrore Harmonizuese/ Ministria e Financave do të njoftojë të gjitha OB-të për obligimet që rrjedhin lidhur me funksionin e auditimit të brendshëm. 2. Njësia Qendrore Harmonizuese/Ministria e Financave do të monitorojë dhe do të kërkojë vazhdimisht nga OB-të që të përmbushin obligimin për funksionin e auditimit të brendshëm, sipas legjislacionit në fuqi	1. TM 1 2021 2. TM 1 - TM 4 - 2021

7	82	<p>1. Ministrinë që ndajnë fonde për bashkëfinancim të projekteve në komuna, të caktojnë nga një anëtarë në komisionet e hapjes dhe vlerësimit të ofertave për t'u siguruar se procedurat e prokurimit për projektet e bashkëfinancuara janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin dhe të jenë të informuar me kohë për zhvillimin e projekteve; dhe</p> <p>2. Të reduktojnë sa më shumë përdorimin e procedurave të prokurimit për kontrata me vlerë minimale në mënyrë që përmes procedurave tjera të sigurojnë një konkurrencë më të hapur dhe të sigurohen çmime sa më të volitshme të tregut.</p>	Qeveria e Kosovës (MI, MPL, MEA, MZHR)	Ministrinë e linjes (MI, MPL, MEA, MZHR) duhet të dërgojë nga një anëtarë në komisionet e hapjes dhe vlerësimit të projekteve në Komunitet përfitues të projekteve të investimeve kapitale, për t'u siguruar se procedurat e prokurimit për projektet e bashkëfinancuara janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin dhe praktikën me të mira të rekomanduara.	TM1/2021
8	85	<p>1. Qeveria të inicioj ndryshimin e Ligjit të NP-ve dhe të bëjë harmonizimet përkatëse ligjore të datave të raportimeve të auditimit financiar, apo të precizohet/parashikohet mbizotërimi i rregulimeve të përcaktuara me njërin apo tjetrin ligj që rregullojnë këtë çështje;</p> <p>2. Qeveria të bëjë interpretim ligjor të mandatit dhe kompetencave të KKRf-së ndërlidhur me auditimin e PVF-ve të NP-ve kur auditohen nga ZKA. Ky interpretim të jetë obligues për KKRf-në, apo në të kundërtën të inicioj plotësim/ndryshimin e ligjit të KRFA-së për t'i eliminuar kundërtënitë e lartpërmendura; dhe</p> <p>3. Qeveria në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, në pajtim me ligjet në fuqi dhe vendimin e Qeverisë të ndërmarrë hapat e nevojshme për transferimin e buxhetit nga komunat në AME, respektivisht në MPB.</p>	<p>Rekomandimi 1-2: Qeveria e Kosovës (Ministria e Financave/KKRf & DL, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit)</p> <p>Rekomandimi 3: Qeveria e Kosovës (Ministria e Financave dhe MPB)</p>	<p>1. Qeveria do të rishikoj ligjin për NP duke harmonizuar datat e raportimit dhe qartësuar mbizotërimin e LMFPF si dhe Ligjit për Zyren Kombëtare të Auditimit në rastet e auditimit të NP.</p> <p>2. MF do të realizojë një analizë ligjore lidhur me mandatin dhe kompetencat e KKRf lidhur me auditimin e PVF të NP nga ZKA, dhe nëse rezultoni e nevojshme, do të rekomandojë opsionin e ndryshimit të ligjit.</p> <p>3. MPB/AME ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme duke filluar nga nënshkrimi i memorandumëve për bartjen e aseteve me të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Ndërsa, pengesa për transfer të mjeteve buxhetore nga niveli lokal në atë qendror ka qenë Ligji i financave të pushtetit lokal, i cili është në procedurë të rishikimit.</p>	<p>1. TM4/2021</p> <p>2. TM2/2021</p> <p>3. TM4/2021</p>
9	85	<p>Kryetarët e komunave Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok duhet të sigurojnë zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave, që kanë për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave ligjore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunave përkatëse.</p> <p>Njëherit, duhet të iniciojnë pa vonësë hartimin e rregulloreve të brendshme për taksat, tarifën dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e ofruara publike.</p>	Komunitet dhe Ministria e Pushtetit Lokal	MPL do të përgatisë një Model rregullor për tarifa ngarkesa dhe gjopa për komunat e apostrofuara në rekomandim të cilat pastaj do të përgatisin rregulloret sipas përgjegjësisë të tyre; si dhe do të monitoroj zbatimin e legjislacionit në fuqi, dhe do t'i rekomandojë Qeverisë përkatëse me gjetjet.	TM4/2020
10	85	Ministria e Arsimit duhet të marrë masa të menjëhershme që të ndalojë të gjitha pagesat e paligjshme për kompensimin e komisioneve të brendshme në universitetet e përmendura më lart, dhe të kërkojë që statutet e tyre të harmonizohen me ligj.	MASHT	Ministria e Financave, duke vënë në dijeni Kryeministrin, do t'i kërkojë MASHT që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ndalimin e kompensimeve të palejuara sipas rekomandimit të ZKA, duke zbatuar LMFPF (neni 80).	TM4/2020
11	93	T'i analizojnë rekomandimet të cilat kanë rezultuar nga auditimet e performancës dhe të përgatisin dhe monitorojnë planin e veprimit për zbatimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve duhet të bëhet duke caktuar dhe mbajtur përgjegjësi funksionet përkatëse në organizatë përmes raportimit të rregullt.	Qeveria e Kosovës & Komunitet	Qeveria do të themelojë një "trupë qeveritare" për të shqyrtuar në baza 3 mujore progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të performancës. Ndërsa, MPL do të konsolidojë dhe pasqyrojë këtë raport për komunat e Kosovës dhe të njejtat t'i përdor edhe për matjen dhe vlerësimin vjetor të performancës së komunave	TM1/2021
12	96	<p>1. Bordet e Drejtorëve të NP-ve përkatëse duhet të analizojnë shkaqet të cilat kanë ndikuar për Modifikim të Opinioneve dhe të merren të gjitha veprimet e nevojshme që çështjet të cilat kanë ndikuar në opinion të korrigjohen apo parandalohen. Gjithashtu, të sigurojnë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që hartimi i PVF të vitit 2020 i adreson të gjitha çështjet që janë ngritur nga auditimi i PVF-ve të vitit 2019; dhe</p> <p>2. Aksionarët të mbajnë përgjegjësi Bordet Drejtuese të NP-ve përkatëse dhe të kërkojnë ilogari për përgatitjen e drejt dhe korrekte të PVF-ve, si dhe zbatimin e rekomandimeve në të gjitha fushat.</p>	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	<p>1. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit duhet që të fuqizojë autorizimet ligjore dhe zbatojë funksionin e saj, duke luajtur rol aktiv me kërkesa ndaj Bordeve të NP për të adresuar çështjet e ngritura në RVA. MEA/NJMNP duhet të raportojë në Qeveri dy here në vit lidhur me adresimin dhe progresin e arritur nga NP.</p> <p>2. Qeveria do të shqyrtojë se paku dy here në vit raportet e MEA lidhur me NP për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të ZKA për NP</p>	<p>1. TM1/2021</p> <p>2. TM4/2021</p>
13	102	<p>1. Në bashkëpunim me Bordet e Drejtorëve, të analizojnë rezultatet financiare të ndërmarrjeve publike, me theks të veçantë të atyre që me vite operojnë me humbje, marrjen e masave për një riorganizim të tyre, analizën e detyrimeve afatshkurtëra dhe hartimin e planeve strategjike me masa konkrete përmirësuese; dhe</p> <p>2. Aksionarët të shqyrtojnë performancën e Bordeve të Drejtorëve, dhe aty ku ka ngjescje në përbushjen e detyrave, të marrin masa për rritjen e përgjegjësisë dhe ilogaridhënies.</p>	Qeveria e Kosovës (Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit) dhe Komunitet	<p>1. MEA do të kërkojë nga Bordet e Drejtorëve të përgatisin raporte financiare 6 mujor për performancën e NP; ndërsa MEA do të përgatisin raport përmbljedhës dhe ta paraqesin në Qeveri për trajtim.</p> <p>2. Qeveria sipas inputit nga MEA do të shqyrtojë se paku dy here në vit raportet lidhur me performancën e NP dhe do të jap rekomandime për Bordet e Drejtorëve.</p>	<p>1. TM 1 - 2021</p> <p>2. TM 3 - 2021</p>